

Postuar: 16/08/2013 - 21:50 by sot.com.al

Nishani titull nderi për drejtorin e “Societe”, Hubert De Saint-Jean



Postuar: 16/08/2013 - 21:50

Kreu i Shtetit Bujar Nishani ka dekoruar sot drejtorin e përgjithshëm të Bankës Societe Generale në Shqipëri, Hubert De Saint-Jean me titull nderi “Për merita të veçanta civile”. E pranishme në ceremoni ka qenë edhe ambasadorja e Francës në vendin tonë, Kristinë Moro.

Hubert De Saint-Jean është Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale në Shqipëri, një bankë që ka 42 degë, dhe u shërben një numri të madh klientësh, individë dhe

biznese në të gjithë vendin.

Në shtator 2011, z. de Saint-Jean u emërua Zv. Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrisë France-Albanie, ndërsa në janar të këtij viti u zgjodh Anetar i Keshillit Drejtues te AAB (Shoqata Shqiptare e Bankave).